



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
URDHRI I PSIKOLOGUT  
KËSHILLI KOMBËTAR



Tiranë më, 11.07.2024

**V E N D I M**

Nr.12, datë 11.07.2024

Sot, më datë 11.07.2024, Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Psikologut, i thirrur nga Presidenti, mori në shqyrtim në rendin e ditës:

- Shqyrtimi i relacionit të Zyrës Juridike, lidhur me procesin zgjedhor të datës 05.07.2024, për shpalljen e kandidatëve fitues për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Psikologut.

**REZULTON SE:**

Bazuar në sa më sipër, është konstatuar nga Zyra Juridike se, bazuar në Ligjin 40/2016 “Për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë”, neni 15, pika 3, gërma a), nuk është arritur kourumi i nevojshëm për të shpallur fitues asnjërin nga kandidatët pjesëmarrës në zgjedhje. Ky nen përcakton se: *“Asambleja Kombëtare zgjedh Këshillin Kombëtar dhe Presidentin e Urdhrit, me votim të fshehtë dhe me shumicë të thjeshtë të të gjithë anëtarëve të saj”*.

Nga procesverbali i Komisionit Zgjedhor ka rezultuar se kanë marrë pjesë në votime 116 (njëqind e gjashtëmbëdhjetë) anëtarë nga 1222 (njëmijë e dyqind e njëzet e dy) anëtarë aktiv në regjistrin themeltar në datën e zhvillimit të zgjedhjeve, prandaj nuk përmbushet kuorumi i pjesëmarrjes së shumicës së thjeshtë të gjithë anëtarëve.

Pasi mori në shqyrtim relacionin sa më sipër, Këshilli Kombëtar vlerëson se, nisur nga përbërja e këtij organi, në kushtet kur kërkohet interpretim juridik lidhur me çështjen se cila do të konsiderohet *“shumicë e thjeshtë e të gjithë anëtarëve të Asamblesë”*, t’i drejtohet për opinion ligjor lidhur me këtë çështje organit kompetent të Urdhrit të Psikologut, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për të ndihmuar në një vendimmarrje konform ligjit, si dhe të pezullojë shpalljen e kandidaturave fituese deri në marrjen e këtij opinion ligjor.

**PËR KËTO ARSYE, VENDOSI:**

1-Të miratojë me 10 (dhjetë) vota Pro, nga 11 (njëmbëdhjetë) anëtarë të Këshillit Kombëtar prezent në mbledhje, kërkesën për marrjen e një opinion ligjor nga organi kompetent, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, lidhur me Nenin 15, pika 3, gërma a), e ligjit 40/2016 “Për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë”, dhe konkretisht, në lidhje me çështjen se cila do të quhet shumicë e thjeshtë e të gjithë anëtarëve të Asmablesë së Urdhrit të Psikologut.



Blv. Gjergj Fishta, Ndërtesa nr. 26, kati II, Ap.9, Tiranë, email:  
[sekretaria@urdhriipsikologut.al](mailto:sekretaria@urdhriipsikologut.al), Tel.: 0035544 51 1804

2- Të miratojë me 10 (dhjetë) vota Pro, nga 11 (njëmbëdhjetë) anëtarë të Këshillit Kombëtar prezent në mbledhje, pezullimin e shpalljes së kandidaturave fituese për vendet vakante të Këshillit Kombëtar, për zgjedhjet e realizuara në datën 05.07.2024.

3-Ky vendim i njoftohet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si dhe kandidatëve pjesëmarrës në procesin zgjedhor realizuara në datën 05.07.2024.

**PRESIDENTE E URDHRI**

**Dr. Valbona TRESKA**



**SEKRETARE**

**Armira BABOÇI**

